



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 213/3 Prot.

Tiranë më 20.02.2019

REKOMANDIM

Nr. 13, datë 20.02.2019

PËR KONTROLLUESIN "DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE"

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1, dhe 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 41 datë 08.02.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave", me objekt:

- Zbatimi i nenit 18 dhe 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është institucioni më i rëndësishëm arkivor në shkallë kombëtare ku grumbullohen, ruhen, përpunohen dhe shërbehen dokumentet kryesore, që dëshmojnë për historinë e kombit dhe të shtetit shqiptar.

Nga verifikimi i kryer në vend, rezultoi se:

1. Kontrolluesi nuk ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.
Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1 të nenit 21 dhe nenit 22 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar: "...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet

ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

2. Kontrolluesi nuk ka vendosur një rubrikë “*Politikat e Privatësisë*” në portalin <http://www.albarchive.gov.al>, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal. Informacioni i publikuar në “*Politikat e Privatësisë*”, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit, pika 1: *Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale... ”.*

3. Formulari me titull “*Kërkesë për informacion*”, përmban të dhëna personale të qytetarëve, kontrolluesi ka marrë masa për të vendosur referencën ligjore mbi të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit (DPA) në kuadër të mbrojtjes së këtyre të drejtave.

4. Konstatohet se kontrolluesi nuk informon nëpërmjet tabelave subjektet e të dhënave “*nëpunës*”, “*vizitorë*”, etj., mbi prezencën e sistemit të video-survejitimit (CCTV) megjithatë, sipas Udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit “*Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejitimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”. Modeli standard i miratuar ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë etj.

Konstatimi sa i përket informimit jo të plotë të subjekteve të të dhënave, mbi qëllimin e përpunimit të të dhënave, ushtrimit të të drejtave, të drejtën e ankimit etj., gjatë përpunimit e të dhënave personale imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejitimit (CCTV) nga kontrolluesi, përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit dhe Udhëzimit Nr.3/2010 të Komisionerit “*Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejitimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin i cili u lexua në prani të palëve. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesit e kontrolluesit u shprehën se nuk ka pretendime, por nga institucioni po ndërmerren masa për rikuperimin e konstatimeve të lëna nga grupi i kontrollit.

Kontrolluesi ka reaguar në mënyrë të menjëhershme për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, duke “*Njoftuar*” Zyrën e Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave personale.

Nga verifikimi i “*Njoftimit*” të kontrolluesit, mbi përpunimin e të dhënave personale, është konstatuar se është i nevojshëm përditësimi i tij sa i përket rubrikave 3 dhe 4 të “*Formularit të Njoftimit*”.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 29, 30, 31 dhe 32 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave" në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të informojë subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale, qëllimin e përpunimit, mjetet dhe mënyrat e përpunimit, përhapjen e të dhënave etj., nëpërmjet rubrikës "Politikat e Privatësisë" në portalin zyrtar <http://www.albarchive.gov.al>.
2. Kontrolluesi "Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave" në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të informojë subjektet e të dhënave personale mbi praninë e sistemit të video vëzhgimit nëpërmjet tabelave informuese, sipas modelit standard të miratuar nga Zyra e Komisionerit, me Udhëzimin nr. 3/2010 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".
3. Kontrolluesi "Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave", në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e "Njoftimit" pranë Zyrës së Komisionerit, në lidhje me "kategoritë e subjekteve të të dhënave", "kategoritë e të dhënave personale që përpunohen" etj.
4. Kontrolluesi "Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave", të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
5. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 20.02.2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

